



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE**  
**SPITALI RAJONAL ELBASAN**

**Elbasan,më 09 / 02 / 2024**

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
TE VEÇANTA PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: REHABILITIM I HAPESIRES TERRITORIALE TE  
SPITALIT RAJONAL ELBASAN**

---

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45000000-7 Pune ndërtimi**

---

**VLERA E FONDIT LIMIT: 39,816,525 (tridhjetë e nente milion e teteqind e  
gjashtembedhjete mijë e peseqind e njezet e pese) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Elbasan** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**A. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**REHABILITIM I HAPESIRES TERRITORIALE TE SPITALIT RAJONAL ELBASAN**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë :**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*
- c. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1*

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë :**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2020, 2021, 2022**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare 2020, 2021, 2022** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009, neni 41, pika “c”, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve, *kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Shënim:* Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", sidhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", sidhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
Dhe /ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël sedyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.2** Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, të DST,
  - Kontratën/at e Sipërmarrrjes;
  - Situacionin përfundimtar të objektit;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Fatura tatimore.

- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimtar të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  - Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Fatura tatimore
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.3** Operatori Ekonomik, duhet të vetëdeklarojë (sipas Shtojcës 8 të DST), se disponon fuqinë minimale punëtore jo më të vogël se 65 (Gjashtedhjetë e pese) punonjës me kohe te plote, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit te prokurimit për periudhën Shtator 2023 – dhjetor 2023.

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që, nga operatori ekonomik të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën shtator 2023 - dhjetor 2023.
- b) Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

**\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e

objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës, afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ.

**2.3.4** Operatorët Ekonomike, duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë, duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i liçensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës dhe duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### PUNIME TË PERGJITHSHME NDËRTIMI

- NP- 1 A Punime gjurmimi në tokë.
- NP- 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile industriale, veshje fasada
- NP- 4 B Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
- NP- 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS- 4 A Punime rifiniture të muratues dhe të lidhura me to...
- NS- 6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS- 18 A Punime topogjeodezike

*Operatorët e huaj, duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës), Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008).*

#### **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Sublic”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për liçensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

*Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit..*

*Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.*

<i>Kategori a e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të ushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i i kërkuar për kategorinë ë respektiv e</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gjurmimi në tokë”: Konsiderohen gjurmimet, sistemet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.  gjurmimi në tokë.	Punime gjurmimi dhe të themeleve të rrugëve me zinxhir deri në 50 cm eskavator dhe shkarkim në tokë	A	0-20 milion
NP-3	“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile e industriale, veshje fasadash”: Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.	Punime suvatimi, veshje e bojatisjeje ..	A	0-20 milion
NP-4	Rrugë, mbikalime, ura, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Punime për bazamentin e rrugës dhe shtresat konsumuese	B	21-50 milion

		te rruges .		
NP-12	Punime te inxhinierise se mjedisit	Konsiderohe n ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësi mit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme.	A	1-20 milion
NS-4	Punime rifiniture te muartures dhe te lidhura me to	Punime suvatimi , veshje e bojatisje	A	1-20 milion
NS-6	Sinjalistika rrugore jodriçuese	Punimet per sinjalisten horizontale dhe vertikale te parashikuara ne preventiv.	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike.	Punimet per piktimin e pjerresive terthore te rruges sipas [projektit	A	0-20 milion

### **2.3.5 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet.**

**2.3.5/1** Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të paraqesë/in me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 në DST:

Se disponon në stafin e tij si Drejtues Teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/topograf 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Elektronik 1 ( nje)

Inxhinierët e sipërcituar, duhet të figurojnë si **drejtues teknik në licensën** e Operatorit Ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **shtator 2023 – dhjetor 2023**.

Për inxhinierët, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

- Kontratat e punës (të vlefshme);
- Diplomat përkatëse;
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **shtator 2023 - dhjetor 2023**.

**2.3.5/2** Operatori pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplome, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajt **shtator 2023 - dhjetor 2023**, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi - Profili Gjeoteknik 1 (një)
- Inxhinier Ndertimi - Profili Transport 1 ( nje)
- Arkitekt 1 ( nje)

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*



**Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:*

<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime Germimi dhe Prishje, punimet per nenshtrasat rrugore , shtresat asfaltike sipas kuotave te dhena nga ing gjeodet )</i>
<i>1 (nje)Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>Ne preventivin fillestar percaktohen volume konkrete pune te domosdoshme per tu ndjekur nga inxhinieri hidroteknik persa i perket volumit te pergjithshem te parashikuar ne preventiv  Punime ne ndertimin e parkimit Nr.1 , Punime ne ndertimin e parkimit Nr.2</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Gjeodet</i>	<i>Eshtë përgjegjës për punimet per profilat terthore duke dhene pjerresite sipas kushteve te zbatimit</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Mjedisi</i>	<i>Kerkohet inxhinier mjedisi pasi kemi te bejme me punime germimi, ndertimi, heqje dherash etj, qe kane ndikim negativ ne mjedisin perreth. Gjate zbatimit te projektit, eshte e pashmangshme qe ne realizimin e punimeve te kete mbeturina e inerte te cilat paraqesin rrezikshmeri per komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet te realizohet ne perpikmeri dhe ne kohe reale, prandaj asistenca e nje inxhinieri mjedisi do te jete e domosdoshme.</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Elektronik</i>	<i>Eshtë përgjegjës për punimet per profilat terthore duke dhene pjerresite sipas kushteve te zbatimit</i>
<i>1 ( nje) Inxhinier Ndertimi</i>	<i>Strukturat mbajtese te dheut, permiresime bazamentesh te</i>

<i>profili Gjeoteknik</i>	<i>rrugeve et. Gjithe preventive parashikon zera ku eshte e nevojshme prania e ing.gjeoteknik</i>
<i>1 ( nje) Inxhinier Ndertimi profili Transport</i>	<i>Preventivi parashikon nderhyrje ne rruge e sheshe ku kerkohet prania e ing. Ndertimi profile transport,  Punime ne rruge nga parkimi nr 1 deri te dalja nga spitali..</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Arkitekt</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të ndryshme të objektit që do të rikonstruktohet, sipas parashikimeve në projektin arkitektonik .</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Elektrik</i>	<i>Punimet elektrike sipas preventivit</i>

**2.3.5/3** Operatorët ekonomik pjesëmarrës të kenë në stafin e tyre min. 1 (nje) punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këta specialistë të paraqiten kontrata e punës, diploma dhe çertifikata përkatese e dhënë nga një organizëm i licencuar shqiptar ose i huaj si dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën shtator 2023 - dhjetor 2023.

***Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.***

**Argumentimi:**

Specialiste per ndihmen e pare jane te nevojshem per shkak te profileve te ndryshme te puneve dhe te terrenit, per kete arsye eshte parashikuar qe operatori ekonomik te kete nje person, pa percaktuar profesionin e tij i cile te kete nje trainim me special per dhenie te ndihmes se pare. Ne objekt do te kryhen punime te natyrave te ndryshme ne keto kushte duhen parashikuar dhe parandalimi i problematikave te mundshme shendetesore.

**2.3.5/4.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë (*sipas shtojcës 8 të DST*) se ka minimumin punonjës specialist për kryerjen e punimeve, dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën **shtator 2023 - dhjetor 2023**, si më poshtë:

**2 (dy) Teknike ndertimi** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të Lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar.

**1 (nje)** Teknik Topograf/Gjeodet shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te pajisur me kartelet personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**3 (tre) specialiste ndertimi** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te pajisur me kartelet personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - dhjetor 2023;

**3 (tre)** pllakashtrues shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te pajisur me kartelet personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - dhjetor 2023

**2 (dy)** betonues shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te pajisur me kartelet personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - dhjetor 2023;

**3 (tre)** bojaxhinj shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te pajisur me kartelet personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 – dhjetor 2023;

**2 (dy)** elektrikiste shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te pajisur me kartelet personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - dhjetor 2023;

**2 (dy)** Muratorë shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. si dhe te pajisur me kartelet personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - dhjetor 2023;

**1 (nje)** hidroizolues shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe

te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - dhjetor 2023;

**10 (dhjete)** punonjes te thjeshte ndertimi te shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - dhjetor 2023

**Ekskavatorist/Manovrator 3 (tre)**, me kontratat e punës (të vlefshme) dëshmi e aftësisë profesionale per perdorimin e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per shtator 2023 - dhjetor 2023. te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të deklarojë (*sipas shtojcës 8 të DST*) se ka të punësuar punonjes me dëshmi te aftësisë profesionale per perdorimin e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor si me poshte:

**Automakinistë 2 (dy)** me kontratat e punës (të vlefshme), dëshmi e aftësisë profesionale per perdorimin e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per periudhën shtator 2023 - dhjetor 2023, te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**Buldozerist 1 (nje)**, me kontratat e punës (të vlefshme), dëshmi e aftësisë profesionale per perdorimin e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per periudhën shtator 2023 - dhjetor 2023, te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar.

**Shoferi Kamioni 4 (kater)**, me kontratat e punës (të vlefshme), leje drejtimi minimalisht kategoria C (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per shtator 2023 – dhjetor 2023. te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

***Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.***

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemr i punonjësit	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Profesionit	Institucioni publik/privat lëshues i çertifikatës/diplomës	Nr. NIPT( Në rast se lëshuesi është institucion privat)

( plotesimi i tabelës është i detyrueshëm për operatorët e ekonomike që në fazën fillestare të konkurimit)

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme janë vendosur në zbatim të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nëni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

**2.3.7** Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licencuar, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2023 – dhjetor 2023 (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqese 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyre e pjesemarrjen ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktemarreveshje).

### **Argumentimi**

i pikës 2.3.7, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

**2.3.8** Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipollogjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhiniere, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike

të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2023 - dhjetor 2023, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

***Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST***

**Argumentimi :** i pikës 2.3.11 të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjetë punësimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

**2.3.10** Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve te ngurta, inerte”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25, se bashku me aktin e miratimit ku minimalisht te perfshihen kodet **17 05 04** dhe **17 09 04**.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si*

grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi

**2.3.11** Operatori Ekonomik duhet të ketë 1 (nje) inxhinjer/ punonjes si “Ekspert” për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në përputhje të Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”. Per kete duhet te paraqitet diploma, kontrata individuale e punës si dhe çertifikata për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis te leshuar nga Ministria e Mjedisit..

*Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.*

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kritereve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi :** i pikës 2.3.9 të kritereve të veçanta për kualifikim, është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet mjedisore i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet te specializuara ne fushen e ndikimit ne mjedis , nëpërmjetë punesimit të një personi , apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individe apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

**2.3.12** Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera; Dëshim për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Operatori/ët ekonomik, të vetëdeklarojnë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (*shtojca 8*), për mjetet dhe pajisjet si më poshtë:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-18 ton	Ne pronesi ose qira	cope	2
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi ose qira	cope	3
3	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 5 deri ne 8 ton, me vinc	Ne pronesi ose qira	cope	2
4	Ekskavator zingjir mbi 15 ton	Ne pronesi ose qira	cope	3
5	Fadrome me goma	Ne pronesi ose qira	cope	2
5	Minieskavator	Ne pronesi ose qira	cope	3



6	Bobcat	Ne pronesi ose qira	cope	2
7	Rrul vibrues gome - hekur mbi 18 ton	Ne pronesi ose qira	cope	1
8	Rrul vibrues hekur-hekur	Ne pronesi ose qira	cope	2
9	Buldozer S-80/100 KF	Ne pronesi ose qira	cope	1
10	Vibrator thellsie	Ne pronesi ose qira	cope	1
11	Gjenerator	Ne pronesi ose qira	cope	1
12	Autobetoniere	Ne pronesi ose qira	cope	3
13	Autopompë betoni	Ne pronesi ose qira	cope	1
14	Armaturo betoni	Ne pronesi ose qira	m2	500
15	Saldatrice	Ne pronesi ose qira	cope	1
16	Rimorkio peshe mbajtese mbi 15 ton	Ne pronesi ose qira	cope	1
17	Agregate per prerje bimesie	Ne pronesi ose qira	cope	1
18	Kamioncineme kapacitet mbajtës 1 - 2ton	Ne pronesi ose qira	cope	2
19	Betoniere kantieri	Ne pronesi ose qira	cope	1
20	Makineri Vijezi	Ne pronesi ose qira	cope	1
21	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	Ne pronesi ose qira	cope	1
22	Kantier Stacionar	Ne pronesi ose qira	cope	1
23	Gjenerator	Ne pronesi ose qira	cope	2
24	Aparat Topogjeodezik	Ne pronesi ose qira	cope	1
25	Tokmak Ngjeshes	Ne pronesi ose qira	cope	2
26	Ekskavator me goma	Ne pronesi ose qira	cope	1
27	Greider me targa	Ne pronesi ose qira	cope	1
28	Asfaltoshtruese	Ne pronesi ose qira	cope	1
29	Autobitumatrice	Ne pronesi ose qira	cope	1
30	Freze Asfalti	Ne pronesi ose qira	cope	1
31	Fshese per pastrimin e rruges	Ne pronesi ose qira	cope	1
32	Damper kantieri	Ne pronesi ose qira	cope	1
33	Prerese Asfalti	Ne pronesi ose qira	cope	1

**-Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:**

**A. Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:**

1. Leje qarkullimi, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR (e vlefshme).
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), (të vlefshme), lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar (e vlefshme).
4. Çertifikata e transportit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR (e vlefshme).

**B. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten**

1. Leje qarkullimi, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR.

2. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga D.P.SH.T.RR (e vlefshme).
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), (të vlefshme), lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar (e vlefshme).
4. Kontrata përkatëse e qirasë, (e vlefshme).
5. Çertifikata e transportit për të tretë ose në emër të qeramarrësit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR (e vlefshme).

**C. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:**

1. Fatura tatimore e blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

**D. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:**

1. Fatura tatimore të blerjes, akt zhdoganimi për mjetet e importuara;
2. Kontrata përkatëse e qirasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**E.** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkepunimi impiantet si me poshte vijon:

- a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte
- b. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qera ose kontrate bashkepunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/bashkëpunimit.

(KVO do te verifikojë nepermjet QKB nese impianti i prodhimit te inerteve/betonit eshte i pajisur me license 3.1.B, ne rast te kundert OE do te skualifikohet).

**F.** Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon duhet të disponojë :

- Kokore, minimumi 65 copë;
- Jeleke Fosfoeshente, minimumi 65 copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 5 copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën, minimumi 2 copë;
- Kompleti ndimës së shpejtë, minimumi 5 copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 20 copë.
- Kulle ndricimi 1 cope
- Semafor Kantieri 1 cope
- Karroce tip karrel me mbishkrimin “ Punime ne rruge “ cope 1

Është e mjaftueshme paraqitja e vetëdeklarimit *sipas Shtojcës.8 të DST-së*

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**2.3.13** Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetëdeklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) *sipas Shtocës Nr. 8 të DST-së*. Në rast deklarimi të rremë, do të vepohet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**2.3.14.** Operatori/et ekonomik ofertues, duhet të deklarojë që, të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara në pikën 2.3.12 të Kapacitetit Teknik, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera, afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt prokurimi, **janë shkak skualifikimi**. Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve, si gjatë vlerësimit të ofertave, ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rremë, do të vepronet në përputhje të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

**2.3.15** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme) si më poshtë:

- **Çertifikatë S SH EN-ISO 9001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë, e vlefshme*). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë S SH EN-ISO 14001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit, e vlefshme*). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë SSH ISO 45001:2018** ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

**Çertifikatë SSH ISO 50001:2018** ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të energjise ). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit

**Çertifikatë SSH ISO 27001:2013** ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të sigurise se informacionit). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit

\* Të gjitha çertifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkomëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit, duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt – Marrëveshjes).

Nëse ofertuesi do të paraqitet si Bashkim Operatorësh, çertifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra sa më sipër.

**Argumentimi :** Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

### **2.3.16 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:**

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (**bordura betoni, materiale sinjalistike, elektrike, ndricues**). Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.
- Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre per produktin Bojë për lyerjen e godinave, ambienteve të brendshme dhe të jashtme, shoqëruar me EN ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015, ISO 45001:2015 dhe PASS 99:2012, raport analizimi për bojë lyerje muri, lëshuar nga inspektoriati shtetëror teknik dhe industrial ose institucione të tjera të akredituara. Ne rastin e kontrates me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

**Shenim:**Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet :  
“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/entikontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/entikontraktori kërkon ofertuesit të kualifikuar, ipari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentete tjerashoqërueset e ofertës, të dorëzuaranë rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjtuara me origjinalin**

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në **gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës)**, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të çertifikuara “Apostile”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

Gjithashtu operatori ekonomik duhet te dorezoje :

- Grafiku i punimeve sipas te gjitha zerave te preventivit dhe afateve te parashikuara nga Autoriteti Kontraktor.
- “Planin e Sigurisë në Kantier” për punimet në objekt në formatin sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë", të ndryshuar me VKM-në Nr.742 datë 06.11.2003.
- Analizat e cmimeve per cdo ze te preventivit

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipollogjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhiniere, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike :**

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit dhe relacionet teknike përkatëse, bashkëlidhur DT-ve, të hartuara nga shoqëria projektuese.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku cilësohet se: “Në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme, detyrat e mëposhtme kryhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit :

- Hartimi i specifikimeve teknike;
- Përllogaritja e fondit limit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik;
- Hartimi i kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;
- Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimit).

Pas hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit dhe kriterëve për kualifikim Njësia e prokurimit, në zbatim të pikës 3, të manualit teknik “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, miratuar me udhëzimin nr. 07, datë 30.7.2021 të APP, si dhe

në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, vendosi si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave

**Data : 04/03/2024 Ora 10:00.**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**